



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

237/4

Nr. 247 prot.

Gjirokastrë, më 09.03.2023

MIRATOHET

PREFEKTI

Odise Kote



PLAN MASASH

**PËR TASK-FORCËN RAJONALE NDËRINSTITUCIONALE MBI MENAXHIMIN DHE MBARËVAJTJEN E SEZONIT TURISTIK
VEROR 2023 NË QARKUN GJIROKASTËR**

Nr.	Veprimet që do ndërmerren	Zbatimi i veprimeve, mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit		
		Zbatimi		Monitorimi i zbatimit
		Institucioni/Dega/Inspektorati Shtetëror	Afati	
1	Të organizohet takimi i Task-Forcës Rajonale Ndërinstitucionale për miratimin e Planit të Masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2023.	Prefekti i Qarkut Gjirokastrë Anëtarët e Task-Forcës Rajonale Ndërinstitucionale për sezonin turistik 2023	Gjatë muajit Mars	Prefekti i qarkut Gjirokastrë Institucionet shtetërore në nivel vendor & Degët Territoriale
2	Në fushën e rendit dhe sigurisë publike, nga DVP të: 2.1 Marrja e masave të nevojshme për garantimin e rendit dhe rritjen e sigurisë publike. 2.2 Sigurimin e informacionit të nevojshëm policor për parandalimin e veprave penale, kryesisht	Drejtoria Vendore e Policisë	Gjatë gjithë sezonit	Prefektit i qarkut Gjirokastrë

	vjedhjet e kabinave, makinave, lokaleve të tregtisë, apo vjedhje te tjera, të cilat shqetësojnë pushuesit.			
3	Zbatimi i legjislacionit që sanksionon krimin mjedisor si krim penal, me fokus të shtuar zonat turistike.	Drejtoria Vendore e Policisë	Gjatë gjithë sezonit	Prefektit i qarkut Gjirokastrë
4	Të ushtrohen kontrolle nëse mjetet e transportit të turistëve kanë lidhur kontratë me operatorin/agjencinë turistike, emri i së cilës duhet të jetë i ekspozuar dukshëm.	Drejtoria Vendore e Policisë	Gjatë gjithë sezonit	Prefektit i qarkut Gjirokastrë
5	Mikëpritje, masa të shtuara dhe lehtësim procedurash për vizitorët dhe emigrantët në 3-pikat e kalimit të kufirit.	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Drejtoria Vendore e Policisë	Gjatë gjithë sezonit	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin
6	6.1 Të zbatohet programi i kontrollit për matjet për nivelin e zhurmës në destinacionet turistike nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit dhe struktura përgjegjëse në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore. 6.2 Të kryhen monitorime periodike për ndotjen akustike në destinacionet turistike.	Agjencia Rajonale e Mjedisit Drejtoria Vendore e Policisë ISHSH Gjirokastrë NJVKSH e qarkut Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
7	7.1 Monitorim i pastrimeve frekvente në zonat turistike, organizim i aksioneve për pastrimin të territoreve të zonave turistike, veçanërisht në kohën e flukseve të larta të vizitorëve. 7.2 Zbatim rigoriz i Planit Kombëtar të Pastrimit sipas planeve javore dhe mujore.	Të gjitha institucionet e përfshira Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë Të gjitha institucionet e përfshira
8	Të kryhen kontrolle në bashkëpunim me Policinë e Shtetit për mbrojtjen, kontrollin dhe monitorimin e territorit, medisit dhe pyjeve nga ndërhyrjet/ndërtimet e kundërligjshme.	Dega e IKMT-së Drejtoria Vendore e Policisë	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë

9	<p>Përmirësimi rrënjësor i sinjalistikës rrugore me elementet e duhura.</p> <p>9.1 Të publikohet/informohet informacioni turistik për të gjithë të interesuarit nëpërmjet funksionimit dhe vënies në efijencë të plotë të zyrave të Informacionit Turistik (baza e të dhënave me oraret dhe kontaktet përkatëse të muzeve, monumenteve të kulturës, parqeve arkeologjike, zonave të mbrojtura).</p> <p>9.2 Të merren masa për vendosjen e sinjalistikës dhe informacionit në lidhje me shërbimet bazë: vënia në dispozicion e numrave të telefonit të emergjencës si policia, spitali, qendrat shëndetësore, etj.</p> <p>9.3 Vendosja e sinjalistikës informuese turistike me të dhënat si objektet muzeale, restorante, hotele, bujtina, etj.</p>	<p>Drejtoria Vendore e Policisë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore DRKK Gjirokastër ADZM Gjirokastër</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit turistik</p>	<p>Prefekti i qarkut Gjirokastër</p>
10	<p>10.1 Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për ekspozimin e çmimeve për produkt/shërbimet e ofruara në vende të dukshme për publikun.</p> <p>10.2 Kontrolli i subjekteve tregtare për zbatimin e procedurës së fiskalizimit.</p> <p>10.3 Kontrolli i subjekteve tregtare në destinacionet turistike për lëshimin e faturës tatimore.</p> <p>10.4 Kontrolli i tatimpaguesve nëse janë regjistruar në përgjegjësitë përkatëse tatimore.</p> <p>10.5 Verifikimi i deklarimit të punonjësve dhe pagave në organin tatimor.</p>	<p>Drejtoria Rajonale e Tatimeve</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit turistik</p>	<p>Prefekti i qarkut Gjirokastër</p>
11	<p>Të merren masa për evitimin gjatë sezonit turistik të rrugëve në ndërtim dhe të realizohen me prioritet investimet për rikonstruksionin, mirëmbajtjen dhe</p>	<p>Drejtoria e Rajonit Jugor</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit turistik</p>	<p>Prefekti i qarkut Gjirokastër</p>

	pajisjen me sinjalistikë rrugore të rrugëve drejt destinacioneve turistike dhe natyrore.			
12	Të përditësohet harta e aksidenteve rrugore (hot spot), të publikohet dhe vënia në dispozicion agjencive turistike.	Drejtoria e Rajonit Jugor Policia e Qarkullimit Rrugor	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
13	13.1 Të merren masa për furnizimin me ujë të pijshëm dhe sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza veçanërisht në destinacionet turistike. Të përgatiten plane koordinimi për të patur nën kontroll situatën për çdo defekt të mundshëm gjatë gjithë sezonit turistik. 13.2 Të kryhet periodikisht monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm.	Bashkitë e qarkut Gjirokastrë, Shërbimi i Ujësjellës- Kanalizimeve të gjithë bashkive të qarkut, ISHSH Gjirokastrë NJVKSH-të e qarkut	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
14	Të sigurohet furnizim i vazhdueshëm me energji elektrike, të merren masa të shtuara për rregullimin në kohë sa më të shkurtër në rast të ndërprerjeve të energjisë elektrike në zonat turistike.	Drejtoria Rajonale e OSHEE	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
15	Të merren masa për inspektimin e subjekteve që prodhojnë, përpunojnë dhe tregtojnë prprodukte ushqimore për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorit.	Drejtoria Rajonale e AKU-së	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
16	Të sigurohet shërbimi i vazhdueshëm shëndetësor në zonat turistike në përputhje me rekomandimet dhe urdhërat e MSHMS.	NJVKSH e qarkut Gjirokastrë (Qendrat Shëndetësore)	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
17	17.1 Organizimi i shërbimit shëndetësor në qendrat shëndetësore që do të funksionojnë pranë zonave turistike të vendit gjatë sezonit veror (identifikimi i strukturave që do të shërbejnë si qendra shëndetësore verore, vendosja e sinjalistikës, pajisja	NJVKSH e qarkut Gjirokastrë	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë

	e tyre me pajisjet e nevojshme). 17.2 Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor sipas një liste të përcaktuar shërbimesh për qytetarët që paraqiten pranë këtyre qendrave.			
18	18.1 Ofrimi i shërbimeve të urgjencës mjekësore në të gjitha nivelet e tij, për të gjithë shtetasit shqiptarë apo të huaj. 18.2 Garantimin e shërbimit falas nga urgjenca mjekësore në kohën e duhur për shtetasit që konsiderohen në gjendje rrezikshmërie të lartë për jetën, sipas protokolleve të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.	Spitali Rajonal “Omer Nishani”		Prefekti i qarkut Gjirokastrë
19	Të bëhen inspektime dhe kontrole për respektimin e normave dhe rregullave higjieno-sanitare në objektet turistike, restorante e struktura akomoduese, subjektet e furnizimit me ujë të pijshëm, pishinat.	ISHSH Gjirokastrë	Gjatë gjithë sezonit turistik	
20	Marrja e masave për respektimin e kritereve në zbatim të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për Transportet Rrugore”, i ndryshuar.	Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
21	21.1 Vënie në rolin e guidës së stafit të zonave të mbrojtura në shtigjet e markuara. 21.2 Funksionimin e qendrave ekzistuese të informacionit turistik përmes bashkërendimit të punës m epushtetin vendor. Menaxhimin e vizitorëve në çdo stinë të vitit dhe ofrimi i informacionit të nevojshëm përmes hartave, fletëpalosjeve, etj. 21.3 Informim dhe promovim përmes faqes web dhe rrjeteve sociale.	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë

22	Të publikohen të dhëna për strukturat akomoduese si kontakte, kapacitete, vendndodhje e shërbime; agjencitë turistike dhe për subjekte të tjera turistike sipas shpërndarjes gjeografike dhe destinacionit turistik.	Bashkitë e qarkut Gjirokastrë	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
23	23.1 Të zbatojnë planet për menaxhimin e mbetjeve urbane, shtimin e koshave dhe hartimin e planeve, me fasha orari të përshtatshme për largimin e mbetjeve urbane në të gjithë destinacionet turistike. 23.2 Të hartojnë plane depozitimi të mbetjeve nga subjektet turistike, me orare dhe vende të përcaktuara, të monitorojë grumbullimin e mbetjeve deri në largimin e tyre në vend depozitimin e përcaktuar.	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë
24	Të merren masa për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga rënia e zjarreve, gjatë sezonit në zonat me destinacion turizmin.	Bashkitë e qarkut Gjirokastrë Stacionet e MZSh në bashkitë e qarkut Strukturat e Policisë së Shtetit	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Drejtoria Vendore e Policisë
25	Të raportohet çdo të premtë mbi kontrollet, monitorimet e kryera, problematikat e konstatuara në adresën elektronike zyrtare të Prefektit të qarkut Gjirokastrë.	Të gjithë anëtarët e Task-Forcës Rajonale Ndërinstitucionale për sezonin turistik 2023	Gjatë gjithë sezonit turistik	Prefekti i qarkut Gjirokastrë

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ARIAN KORKUTI